

# **Memorandum Mirekuptimi**

**Midis**

**Komisionit te Mbikeqyrjes te Sigurimeve te Shqiperise (KMS) si institucioni pergjegjes per licensimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarive te sigurimeve, risigurimeve dhe ndermjetesimit te tyre ne Shqiperi**

**Dhe**

**Autoritetit Bankar dhe Pagesave te Kosoves (BPK) si institucioni pergjegjes perkates i autorizuar per kuadrin rregullator ne sigurime ne Kosove, ne emer te Misionit te Administrimit te Perkoheshem te Kombeve te Bashkuara ne Kosove (UNMIK)**

**Per**

**Bashkepunimin ne fushen e mbikeqyrjes se sigurimeve**

**Duke konsideruar**, qe KMS dhe BPK ( ketu me poshte do te quhen " Palet " ) deshirojne te bashkepunojne ne kuadrin e funksioneve te tyre ligjore per te licensuar, mbikeqyrur dhe rregulluar aktivitetet e sigurimeve brenda juridiksioneve te tyre;

**Duke konsideruar**, se Palet deshirojne qe nepermjet nje bashkepunimi te tille te ndihmojne ne realizimin e pergjegjesive te tyre respektive dhe te nxisin nje funksionim te mire te aktiviteve nder-kufitare ne sigurime ne juridiksionet e tyre; dhe

**Duke konsideruar**, se Palet deshirojne qe nepermjet nje bashkepunimi te tille te nxisin dhe te zgjerojne gjithashtu shkembimin e informacionit dhe eksperiencen mbi ceshtjet ne sigurime;

**Per kete arsye**, Palet kane rene dakort si me poshte:

## **I. Qellimi i Bashkepunimit**

Me qellim qe te ndihmoje ne shkembimin e informacionit dhe eksperiences lidhur me realizimin e procedurave te vendosura ne ligjet respektive kryesore te tyre persa i perket aktiviteve te tyre dhe nxitjes te nje rregullimi te thelle dhe efektiv per organizimet nder-kufitare ne sigurime ne juridiksionet e tyre, Palet bien dakort te bashkepunojne ne zonat e meposhteme:

(a) Te krijojne procedura, me ane te te cilave njera Pale mund te informoje dhe marre keshille dhe informacion nga Pala tjetere lidhur me aplikimet qe ajo merr nga aplikuesit e sigurimeve me seli qendrore ne juridiksionin e Pales tjetere, per te kryer nje aktivitet sigurimi brenda juridiksionit te saj, nepermjet krijimit te filialeve, degeve, dhe zyrave te perfaqesimit.

(b) Te krijojne procedura, me ane te te cilave Palet mund te njoftojne njeri tjetrin per ceshtjet qe kane te bejne me aktivitetet e sigurimeve dhe themelimin e bizneseve ne sigurime, ne menyre te veçante per ato qe jane licensuar te veprojne ne juridiksionet e te dyja Paleve. Ceshtjet per te cilat duhet te jene informuar perfshijne ndryshime te rendesishme ne legjislacionet e tyre lidhur me sigurimet, dhe informacion mbi themelimin e bizneseve ne sigurime ne lidhje me:

- menaxhimin dhe strukturen e biznesit;
- pronesine;
- rreziqet e tregut;
- likuiditetin;
- mjaftueshmerine e kapitalit;
- evidence lidhur me ankesat e konsumatoreve;
- likuidimi/falimentimi/procedurat e likuiduesit;
- evidenca mbi investigimet dhe kontrollet te kryera nga autoritetet perkatese.

(c) Te vendose procedura, me ane te cilave njera Pale mund te ftoje perfaqesues te Pales tjeter per te marre pjese ne kontrollin e nje filiali, dege apo zyre perfaqesimi te siguruesit ne juridiksionin e Pales tjeter.

(d) Shkembimin e stafit nepermjet programeve te experiences.

(e) Te organizoje takime te rregullta midis Paleve per te diskutuar realizimin e ketij Memorandumi Mirekuptimi, per te shkëmbyer informacion dhe per te adresuar probleme specifike te rregullimit ose probleme qe mund te kene lindur.

(f) Sigurojne dokumentat perkatese, duke perfshire si me poshte:

-organigramat e Paleve me emrat e stafit perkates pergjegjes dhe pergjegjese e tyre; dhe

-listen e filialeve, te degeve dhe te zyrave perfaqesuese te autorizuara per te kryer aktivitet sigurimi ne juridiksionin prites.

## **II. Mundesia ligjore dhe kofidencialiteti**

1. Aktivitetet e kryera ne pajtim me kete Memorandum Bashkepunimi, ne menyre te veçante per ndarjen e informacionit dhe pjesemarrjen ne kontrolle duhet te jene kryer vetem ne shkallen dhe menyren e lejuar nga legjislacioni i Paleve.

2. Palet bien dakord te ruajne kofidencialitetin e çdo informacioni ose materiali te siguruar nga njera Pale per Palen tjeter, dhe te çdo informacioni te njohur nga njera Pale per shkak te shoqerimit te saj me Palen tjeter ne pajtim me kete Memorandum Mirekuptimi qe nuk kane qene bere publike, dhe akoma me tej ata bien dakort se nuk do te bejne te njohur nje informacion ose material te tille per nje Pale te trete pa autorizimin paraprak te Pales tjeter.

## **III. Gjuha e perdorur**

Sipas ketij Memorandumi Mirekuptimi, panvaresisht se Palet mund te bien dakort ndryshe, ato duhet te komunikojne ne gjuhet Shqipe dhe Angleze.

## **IV. Ndryshimi dhe Perfundimi**

1. Ky Memorandum Mirekuptimi mund te jete ndryshuar vetem me shkrim.

2. Ky Memorandum Mirekuptimi mund te jete zgjidhur nga çdo Pale me kushtin qe te njoftoje Palen tjeter me shkrim 90 dite perpara.

## **V. Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

Palet do te perpiqen te zgjidhin ne menyren me te pershtatshme çdo mosmarreveshje qe buron nga ky Memorandum Mirekuptimi.

## **VI. Hyrja Ne Fuqi**

Ky Memorandum Mirekuptimi do te hyje ne fuqi me nenshkrimin e Paleve.

**Ne Prezencen e** perfaqesuesve te autorizuar te Paleve, kane nenshkuar kete Marreveshje ne dy kopje origjinale ne gjuhet Shqipe dhe Angleze, duke qene te dyja kopjet me cilesine e dokumentave autentik, ne daten e deklaruar me poshte.

**Per UNMIK**

---

**Donat Branger  
Drejtor Menaxher  
BPK**

**Date:**

---

**Per KMS**

---

**Gezim Agasi  
Kreyetar  
KMS**

**Date:**

---